

KODI DEONTOLOGJIK FARMACEUTIK

Kreu I

PARIME KRYESORE

Neni 1 Përcaktimi

Kodi Deontologjik Farmaceutik është një bashkësi parimesh dhe rregullash, që përbën mjetin, të cilit i referohet Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë për vënien e këtyre parimeve dhe rregullave tërësisht në shërbim të qytetarit si dhe për mbrojtjen e etikës, dinjitetit dhe nderit të farmacistit.

Neni 2 Njohja dhe antarësimi në Urdhrin e Farmacistëve

Farmacistët duhet ta njohin Urdhrin e Farmacistëve si një Ent Publik, i cili u garanton qytetarëve kërkesat profesionale dhe korrektësinë e sjelljes ndaj tyre. Urdhri i Farmacistëve përfaqëson njëkohësisht interesat e përbashkëta profesionale të farmacistëve dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre, gjithmonë në funksion të profesionit dhe të shërbimit ndaj publikut. Antarësimi në Urdhrin e Farmacistëve është detyrim ligjor për çdo farmacist, që ushtron profesionin e tij në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 Njohja e Kodit Deontologjik dhe Betimi i farmacistit

Çdo farmacist, kur regjistrohet në Urdhrin e Farmacistëve duhet të njohë Kodin Deontologjik Farmaceutik, të bëjë Betimin e Farmacistit, që është Betimi i Hipokratit, i riformuluar në Gjenevë, më 1948, krahas zotimit për zbatimin me përpikmëri, përkushtim, paanësi e ndershmëri të çdo kërkesë të Kodit, gjatë ushtrimit të profesionit.

Neni 4 Njohja e Ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003 “ Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” dhe e legjislacionit farmaceutik .

Farmacisti duhet të njohë dhe të zbatojë Ligjin Nr.9150 të datës 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, legjislacionin farmaceutik si dhe të gjitha ligjet e aktet normative, që kanë të bëjnë me punën e tij. Ai duhet t'i ketë të sistemuara në farmaci botimet e tyre, krahas rregulloreve, udhëzimeve institucionale e literaturës farmaceutike, të domosdoshme për konsultim gjatë punës së përditëshme.

Neni 5 Detyrat dhe misioni i Farmacistit

Për të ushtruar me dinjitet misionin e tij në shërbim të komunitetit, farmacisti duhet:

-Të zotërojë aftësi teorike dhe praktike profesionale, gjithnjë në rritje, për t'i vënë në shërbim të pacientit.

-Të veprojë me pavarësi dhe ndërgjegje profesionale të plotë, në përputhje me principet etike, duke pasur si qëllim kryesor mirëqënien e të sëmurit dhe komunitetit.

-Të njohë dhe të bashkëpunojë me komunitetin për nevojat shëndetësore dhe sociale dhe të ndihmojë në realizimin e tyre.

-Të ketë një sjellje etike dhe profesionale në përputhje të plotë me detyrën e tij si punonjës i kualifikuar i mjekësisë dhe si përgjegjës i drejtpërdrejtë për shëndetin e njerëzve.

-Farmacisti duhet ta ushtrojë detyrën e tij me dinjitet si, gjatë ashtu edhe pas kohës së punës. Shkeljet ose mangësitë gjatë ushtrimit të profesionit, të cilat njollosin figurën e farmacistit, janë të dënueshme.

-Farmacisti ka për detyrë të përditësojë njohuritë e tij shkencore duke u njohur me literaturën bashkëkohore vendase dhe të huaj, për të ruajtur një nivel të lartë kompetence profesionale gjatë ushtrimit të profesionit. Ai duhet të ndihmojë publikun në edukimin shëndetësor. Për mundësimin e këtyre farmacisti merr pjesë në proceset e edukimit të vazhdueshëm profesional të organizuara ose të nxitura nga Urdhri i Farmacistëve, në bashkëpunim me Departamentin e Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë, Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV) dhe me institucionet shtetërore, si dhe në iniciativat e parashikuara nga aktet normative përkatëse për të marrë, në rastet e parashikuara, akreditimet dhe çertifikimet e nevojshme.

-Farmacistit i ndalohet mbajtja dhe dhënia, pa autorizimin përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë, e lëndëve narkotike dhe psikotrope, natyrore, gjysmësinetike apo sintetike të këtij grupi, që përfshihen në listën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për kontrollin e drogave.

Neni 6 Shërbimi farmaceutik

Farmacisti duhet të ofrojë shërbim të njëjtë për të gjithë, pa dallim moshe, seksi, race, kombësie, feje, pikëpamjeje politike, gjendjeje ekonomike, pozite shoqërore etj., duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo individi. Në rast lufte apo katastrofash ai duhet të angazhohet menjëherë për të ofruar ndihmën e tij, duke u vënë në dispozicion të autoriteteve kompetente.

Neni 7 Prania e Drejtuesit Teknik dhe farmacistit në farmaci

Prania e Drejtuesit Teknik në farmaci është e detyrueshme. Dhënia e shërbimit farmaceutik në raste të largimit të tij të përkohshëm, mund të bëhet nga një farmacist tjetër, i punësuar në këtë farmaci i cili duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara me ligj në lidhje me përvojën, provimin profesional dhe kushte të tjera të përcaktuara me akte normative të UFSH-së.

Farmacisti nuk duhet në asnjë rast të lejojë që të punojnë në farmaci persona të tjerë, që nuk janë farmacistë.

Neni 8 Respektimi i traditës dhe i sjelljes etike

Farmacisti duhet të bëjë gjithshka që ka në dorë për të respektuar dhe mbrojtur traditat më të vyera të profesionit, duke zbatuar një standard të lartë profesional dhe një sjellje etike shembullore ndaj të sëmurit, familjarëve dhe ndaj çdo personi tjetër, që i kërkon ndihmë.

Neni 9

Kufizime të aktivitetit profesional

Farmacisti në asnjë rast nuk duhet të përfitojë nga kushtet që i krijon profesioni. Ai nuk duhet të përdorë mundësitë, që i jep vendi i punës për qëllime përfitimi personal, moral dhe material.

Neni 10

Ndihma në raste urgjente

Farmacisti nuk duhet të shmangë dhënien e ndihmës urgjente për çdo njeri që ka nevojë, duke kërkuar njëkohësisht edhe asistencën e specializuar mjekësore.

Neni 11

Marrëdhëniet me kolegët dhe personelin

Gjatë punës së tij, farmacisti duhet të bëjë kujdes për të ruajtur emrin e mirë të profesionit dhe të ketë marrëdhënie të mira me kolegët dhe personelin tjetër mjekësor.

Kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet midis kolegëve duhet të zgjidhen nëpërmjet ballafaqimeve të drejtpërdrejta dhe, në rast moszgjdhjeje, duhet t'u nënshtrohen vlerësimit të Urdhrit profesional.

Kreu II

DETYRAT E FARMACISTIT NDAJ TË SËMURIT

Neni 12

Marrëdhëniet me të sëmurin

Farmacisti duhet të kujdeset për ruajtjen e mirëqënies së të sëmurit dhe të interesave shëndetësore të tij. Marrëdhëniet midis tyre duhet të mbështeten në mirëbesimin e ndërsjellë.

Neni 13

Marrëdhëniet me qytetarët

1. Farmacistit i ndalohet të kufizojë ose ndalojë të drejtën e qytetarit për zgjedhje të lirë të farmacisë ose farmacistit. Farmacisti vepron në përputhje me njohuritë shkencore, duke respektuar plotësisht ligjin në çdo veprim profesional, duke e orientuar shërbimin e tij drejt dhënies së barnave të sigurta dhe qartësisë së këshillave dhe informacionit. Ai duhet ta nxiti pacientin të pyesë për çdo problem që lidhet me barnat.

Farmacisti duhet të ofrojë gadishmërinë për të dhënë ndihmën e lejuar nga ligji për çdo person që është në nevojë. Farmacisti është i detyruar të pajiset me dëshminë e ndihmës së shpejtë.

2. Vënia në dispozicion të pacientit e të gjitha të dhënave dhe sqarimeve që kanë të bëjnë me përmbajtjen, veprimin terapeutik, përdorimin, mënyrat dhe kohët e marrjes së barnave, kundërindikacionet, veprimet anësore dhe papajtueshmërinë e ruajtjes së barnave të dhëna, është detyrim profesional për farmacistin. Ai duhet të japë edhe këshilla e udhëzime higjienike, sanitare dhe dietike plotësuese, në mbështetje të përsosjes së terapisë, duke pasur si qëllim rimëkëmbjen dhe ruajtjen e gjendjes shëndetësore të të sëmurit.

Ndërhyrjet këshillimore, që shoqërojnë dhënien e barit duhet të kryhen duke ruajtur individualitetin e të sëmurit.

Farmacisti merr pjesë në përshtatshmërinë e terapisë nëpërmjet një shërbimi të përpiktë dhe të monitoruar farmakovigjilence, që shtrihet në çdo hallkë nga mjeku te pacienti.

Farmacisti nxit dhe merr pjesë në fushatat e parandalimit të sëmundjeve dhe edukimit shëndetësor.

Neni 14 **Kompetenca profesionale**

Farmacisti duhet t'i garantojë të sëmurit përkushtim dhe aftësi profesionale.

Ai duhet të kryejë punën e tij pa mangësi profesionale dhe etike, në bashkëpunim të hapur me të sëmurin. Shkeljet në këtë drejtim, në vartësi të shkallës së rëndësisë ndëshkohen, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 15 **Dhënia e barnave me dhe pa recetë**

-Farmacisti duhet t'u propozojë të sëmurëve dhe të japë pa recetë vetëm barna të nevojshme dhe që janë në pajtim me listat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

-Farmacisti është i detyruar që, në çastin e paraqitjes së recetës së mjekut ta kontrollojë atë nëse është plotësuar saktë në çdo detaj, sipas normave ligjore. Ajo duhet të ketë detyrimisht të shënuara institucionin ose klinikën nga vjen, emrin, mbiemrin dhe firmën e mjekut, datën e lëshimit dhe vulën. Farmacisti mban përgjegjësi për saktësinë e dosjes së përshkruar, kujdeset deri në korrigjim të dozave të dëmshme si dhe të papajtueshmërive e ndërveprimeve që rrezikojnë terpinë, apo dobësojnë cilësinë e saj. Zgjidhjen e problemeve që lindin nga recetat ai duhet ta bëjë sipas normave të Kodit Deontologjik.

-Farmacisti mund t'u propozojë pacientëve, pas kërkesës së tyre, të bazuar në konsultime paraprake, barna që jepen pa recetë, në përputhje të plotë me listën e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

-Farmacisti ka të drejtë që për problemet e tij shëndetësore të bëjë një recetë personale për barna, me përjashtim të barnave që janë në listat e lëndëve toksike dhe psikotrope.

Neni 16 **Ruajtja e sekretit**

Të dhënat, që farmacisti mëson gjatë kryerjes së detyrës, vlerësohen si të fshehta profesionale. Ai duhet të sigurojë një kënd të veçantë komunikimi sekret me pacientin apo të afërmin e tij që merr barnat. Me dëshirën e të sëmurit farmacisti është i detyruar të mbajë të fshehtë edhe ndaj familjarëve e personave të tjerë edhe pas vdekjes së të sëmurit. Shkelja e këtij parimi bëhet vetëm në rastet kur moskallzimi i të fshehtës mund të përkeqësonte shëndetin e të sëmurit dhe komunitetit si dhe në rastet e kërkuara nga organet gjykuese.

Neni 17 **Vazhdimësia e shërbimit**

Kur farmacisti punon vetëm dhe me kohë të plotë dhe që do të mungojë për një periudhë të caktuar, ai është i detyruar të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit, duke vendosur dukshëm, jashtë farmacisë, një shënim me adresat e farmacive më të afërta.

Neni 18 **Dokumentimi i punës**

Farmacisti ruan dhe mirëmban, sipas detyrimeve ligjore, recetat dhe gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së tij. Çdo abuzim, mashtrim apo falsifikim, me apo pa dashje, dënohet me ligj.

Neni 19 **Ankesat e të sëmurëve**

Të sëmurëve që kanë ankesa lidhur me kujdesin apo për barnat e dhëna duhet t'u jepet një përgjigje e menjëherëshme dhe e përshtatshme. Në raste të veçanta, për këtë qëllim, farmacisti mund dhe duhet të këshillohet me mjekun për të respektuar gjithmonë marrëdhëniet etike, sipas këtij Kodi.

Kreu III

MARRËDHËNIET ME KOLEGËT DHE ME PUNONJËSIT E TJERË TË SHËNDETËSISË

Neni 20 **Respekti reciprok**

Marrëdhëniet midis kolegëve duhet të bazohen në parimet e respektit reciprok. Farmacisti duhet të sillet ndaj kolegëve të tij me ndershmëri, ashtu si ai do të dëshironte që ata të silleshin ndaj tij. Farmacisti nuk duhet të përgojë kolegët e tij dhe të bëjë që i sëmuri të dyshojë për njohuritë dhe aftësitë e tyre. Gjatë ushtrimit të profesionit të tij dhe në interes të pacientit, farmacisti duhet t'u përmbahet parimeve të respektit, të detyrave dhe të të drejtave profesionale të veçanta në marrëdhënie me punonjësit e tjerë të shëndetësisë.

Farmacisti vë në dijeni kolegët me rezultatet e punës së tij tekniko-shkencore si dhe duhet të nxisë takimet e punonjësve të tjerë të shëndetësisë më qëllim shkëmbimin e njohurive dhe të dhënave shkencore të kohës.

Farmacisti, në rastet kur ka vërejtje në lidhje me një recetë, duhet t'i drejtohet mjekut që e ka lëshuar atë.

Marrëdhëniet me punonjësit e tjerë të shëndetësisë nuk duhet të nxiten ose kushtëzohen nga interesa ekonomike.

Farmacisti nuk duhet të promovojë, organizojë ose të marrë pjesë në nismat e bashkëpunimit mjek-farmacist për tërheqjen e recetave në farmacinë e tij nga mjekët e sektorëve publikë apo privatë.

Neni 21

Respekti ndaj mësuesve

Farmacisti duhet të tregojë nderim dhe mirënjohje ndaj mësuesve të tij për dijen, aftësitë profesionale dhe mjeshtërinë, që ka fituar nga ata.

Neni 22

Solidariteti ndaj kolegëve

Nëqoftëse një farmacisti i kërkohet këshillë ose ndihmë profesionale nga një koleg, ai duhet të jetë i gatshëm t'i japë ato me çiltërsi dhe në përputhje me njohuritë më të mira. Ai duhet të jetë solidar me kolegët, që u nënshtrohen akuzave të padrejta.

Neni 23

Marrëdhëniet me praktikantët

Farmacisti duhet të mirëpresë praktikantët, për të ushtruar praktikën mësimore ose profesionale dhe duhet ti ndihmojë ata për t'u bërë farmacistë të aftë dhe të devotshëm për të ushtruar profesionin e farmacistit.

Neni 24

Marrëdhëniet me autoritetet dhe institucionet e tjera të shëndetësisë

Farmacisti, në cilësinë e punonjësit të shëndetësisë, bashkëpunon me autoritetet duke i ndihmuar në arritjen e objektivave të tyre dhe merr pjesë në nismat e edukimit shëndetësor që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqënien e komunitetit (si të farmakovigjilencës, të parandalimit të sëmundjeve, të ruajtjes së mjedisit dhe të mbrojtjes civile).

Farmacisti duhet të mbajë marrëdhënie bashkëpunimi me kolegët, që punojnë në institucionet shëndetësore dhe që ushtrojnë profesionin në fushën e administrimit publik në përputhje me respektin reciprok dhe në të mirë e publikut.

Neni 25

Qëndrimi ndaj sjelljes jo korrekte të kolegëve

Në rast se farmacisti vihet në dijeni të një sjelljeje të papërgjegjshme të kolegut, që mund të ketë lidhje me ndonjë parregullsi etike ose mjekësore, ai nuk duhet t'i diskutojë ato me të sëmurin, me familjarët ose kolegët e tjerë, por me vetë kolegun dhe drejtuesit përkatës të Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 26

Gabimet e bashkëpunëtorëve

Farmacisti është i detyruar të verë në dukje gabimet, që mund të bëhen nga bashkëpunëtorët ose personeli tjetër ndihmës, duke i trajtuar ato me kujdes, pa cënuar dinjitetin e asnjërit dhe asnjëherë përpara të sëmurit, familjarëve apo miqve të tyre.

Kreu IV

KUSHTET E USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Neni 27

Sigurimi i mjedisit të punës

Në ushtrimin e profesionit farmacisti duhet të ketë një mjedis të përshtatshëm dhe mjetet e nevojshme teknike në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Farmacia

Farmacisti, që ushtron profesionin në farmaci duhet të mbajë veshur këmbëbardhë mbi të cilën duhet të jetë dukshëm karta identifikuese profesionale e miratuar dhe e shpërndarë nga Urdhri i Farmacistit.

Karta identifikuese profesionale duhet të përdoret vetëm nga farmacistët e regjistruar në regjistrin profesional të Urdhrit të Farmacistëve, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat shtetërore ose private.

Drejtuari teknik duhet të bëjë kujdes që paraqitja e jashtme dhe ushtrimi i profesionit të organizohet në përputhje me rolin e farmacistit si qendër shërbimesh shëndetësore.

Farmacisti duhet të respektojë në çdo rast ligjet dhe nuk duhet të japë barna pa recetë në kundërshtim të tyre. Bëhet përjashtim për rastet në të cilat, sipas ligjit në fuqi, lind nevoja për të shpëtuar këdo që kërcënohet nga një rrezik i papritur, që kërkon trajtim të menjëhershëm.

Farmacisti nuk mund të mbajë, shpërndajë, ose reklamojë barna, që nuk janë autorizuar për tregti në Shqipëri, edhe në qoftë se kërkesa shoqërohet me recetë mjekësore.

Dorëzimi i barit në duart e qytetarit është e drejtë vetëm e farmacistit. Ai bëhet krahas me sqarimet dhe këshillat e nevojshme të shënuara qartë dhe të artikuluar kuptueshëm për qytetarin.

Lejimi i blerjes, ruajtjes dhe shpërndarjes së barnave nga persona që nuk janë farmacistë në çfarëdoq institucioni shëndetësor, përbën një shkelje të rëndë dhe është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Përsa i përket tregtimit të artikujve parafarmaceutike, kozmetike, etj, të cilët ndihmojnë në ruajtjen dhe cilësinë e shëndetit, farmacisti duhet të veprojë në përputhje me rolin e tij dhe në interes të shëndetit të qytetarit si dhe në interes të figurës së profesionit të farmacistit duke ruajtur njëherazi edhe karakterin profesional të farmacistit.

Neni 29 Reklamat

Publiciteti për shërbime profesionale lejohet të bëhet në mënyrë të tillë që t'i shërbejë informacionit të pacientëve pa qenë tundues për shitje. Ai nuk duhet të jetë i adresuar për farmaci të veçanta dhe nuk duhet të bëhet jashtë farmacisë. Publiciteti duhet të jetë dinjitoz të mos shpjerë në njollosje të profesionit dhe të mos krijojë urrejtje midis kolegëve dhe farmacive. Reklama e barnave në mjetet e informimit publik është e ndauar. Ajo lejohet të bëhet vetëm për barnat OTC, me miratim të Ministrisë të Shëndetësisë. Edhe kjo s' duhet të ketë adresime farmacistësh të veçanta. Drejtuesi teknik i farmacisë dhe farmacisti i punësuar duhet të bëjë kujdes, në mënyrë që çdo reklamë, që ndodhet në farmacinë e tij të jetë në përputhje me ligjin, etikën profesionale dhe praktikën e mirë të farmacisë. Ndalohet ekzpozimi në farmaci i çdo publiciteti nga klinikat mjekësore si dhe publiciteti i vendosur në të nga farmaci të veçanta.

Neni 30 Mosshfrytëzimi i funksioneve administrative

Farmacisti, që kryen funksione administrative ose është i zgjedhur në detyra publike, e ka të ndaluar të shfrytëzojë detyrën për të rritur numrin e klientelës dhe për përfitime të tjera prej saj.

Neni 31 Aktiviteti profesional në Industrinë Farmaceutike

Farmacisti, si njohës shkencor i barnave, duhet të zbatojë rreptësisht dispozitat ligjore, që rregullojnë shpërndarjen falas të mostrave të barnave të mjekët, spitalet dhe çdo strukturë tjetër shëndetësore.

Neni 32 Veprimtaria profesionale në fushën e importimit dhe të shpërndarjes

Farmacisti, që ushtron profesionin e tij në shpërndarjen e ndërmjetme të barnave, duhet të respektojë kufijtë, që i janë vënë nga dispozitat ligjore dhe nga roli që ka. Në mënyrë të veçantë ai duhet të sigurohet që të gjitha barnat të ruhen dhe transportohen në kushtet e duhura, si dhe nuk duhet t'i shesë publikut e personave të paautorizuar për blerje me shumicë (qofshin këta mjekë, infermierë, mami) produkte, shitja e të cilave u rezervohet me ligj farmacistëve që ushtrajnë profesionin në farmaci.

Neni 33 Kontrata e punës

Ushtrimi i profesionit pranë një institucioni privat ose publik bëhet me kontratë me shkrim, ku përcaktohen detyrimet përkatëse të palëve. Çdo projekt-kontratë i komunikohet Urdhrit të Farmacistëve, i cili mund të bëjë vërejtje brenda një afati të shkurtër kohor.

Neni 34

Punësimi i kolegëve

Farmacistit, që ka hapur një farmaci, i lejohet të punësojë farmacistë të tjerë për llogari të tij, vetëm kur janë të pajisur me Çertifikatë Anëtarësimi përkatëse.

Neni 35 Respektimi i çmimeve të barnave

Farmacisti duhet të respektojë çmimet e barnave, siç janë në pullat e sigurisë. Përqindja e fitimit të tij s' duhet të kalojë masën e caktuar me ligj.

Kreu V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 36 Respektimi i Kodit

Është detyrë e të gjithë farmacistëve, të regjistruar në Urdhrin e Farmacistëve, të respektojnë nenet e këtij Kodi.

Neni 37 Masat disiplinore

Mosnjohja e neneve të këtij Kodi nuk e përjashton farmacistin nga përgjegjësia që vjen nga moszbatimi i detyrave etike e deontologjike të përshkruara në këtë Kod. Masat disiplinore, që rrjedhin nga moszbatimi i këtij Kodi përcaktohen sipas rregullores për Komisionet Disiplinore të Gykimit Profesional (KDGJP) të Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 38 Njoftim i Urdhrit të Farmacistëve për shkeljet

Çdo anëtar i Urdhrit të Farmacistëve, çdo pacient si dhe çdo konsumator barnash që komunikon me farmacistë, duhet të njoftojë organet përkatëse të Urdhrit të Farmacistëve për të gjitha shkeljet e këtij Kodi.

Neni 39 Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me VKK Nr.6.Prot, Date18/05/2006, rishikuar me VKK Nr.22, date 09.07.2010.